

23 dhjetor

Pushimi i djeshëm i së dielës nuk ndikon në udhëtimin tonë në shpresën e krishterë, sepse Ungjilli përkonte me atë që dëgjuam edhe të shtunën e kaluar dhe për të cilën reflektuam.

Dhe reflektimi ynë bazohej në mundësinë që shpresa jonë të verifikohet; të kishte sy feje për t'i parë veprat e mrekullueshme që bën Hyji në jetën tonë dhe në këtë mënyrë të ushqente shpresën tonë.

Sot, në njëfarë mënyre, reflektimi ynë, i ndihmuar nga Fjala e Hyjit që kemi dëgjuar, është në të njëjtën linjë dhe na ofron figurën e Gjonit Pararendës si një ikonë shprese, pasi shpall praninë e Mesisë. Të dielën e dytë të Ardhjes patëm mundësi ta sodisnim këtë ikonë shprese; sot e shohim përsëri nga një këndvështrim tjetër, atë të babait të tij Zakarisë, i cili e njehej veprën e Zotit pasi dyshoi dhe pas nëntë muajsh memecërie.

Objekti i shpresës së tij, pasi ka fshirë turpin e mallkimit të lidhur me shterpësinë e gruas së tij, tani ka një fytyrë, atë të Gjonit. Jo vetëm kaq, por ka ndryshuar edhe këndvështrimin, sepse nuk bëhet më fjalë për të parë të përmbushur dëshirën për një fëmijë, por edhe për të qenë një mjet në duart e Hyjit për të kryer veprën e tij të mrekullueshme të shpëtimit.

Të nxitur nga ky Ungjill, pyesim veten: a ka profetë shprese në ditët tona? Përgjigjja mund të jetë vetëm pozitive. Nga ana tjetër, pikërisht kështu kam dashur që ta titulloja librin biografik të Martirëve tanë të Lumë Luigj Paliq dhe Gjon Gazulli, duke parë në figurat e tyre **dy profetë të shpresës**, meqë punuan për drejtësinë dhe paqen e popullit të tyre, duke rrënjosur, në këtë mënyrë, një shpresë të re te njerëzit e tyre.

Cilët janë profetët e shpresës në kohën tonë? Nuk duhet të kërkoni shumë larg: thjesht shikojeni veten në pasqyrë. Çdo i krishterë, si Gjon Pagëzuesi, është i thirrur, falë pagëzimit të tij, të jetë një profet shprese: domethënë, të kumtojë praninë e Hyjit në ngjarjet dhe në historinë bashkëkohore; t'u themi të gjithëve se Hyji është një Atë i mirë dhe kujdeset për të gjithë bijtë e tij; se Krishti vdiq dhe u ngjall për shpëtimin tonë dhe se i pret të gjithë në një përqaftim mëshirë dhe paqeje.

Kujtimi i lindjes së Jezusit, për të cilin po përgatitemi këto ditë, ngjallte te secili prej nesh shpresën dhe dëshirën që shpëtimi të bashkëndahet me të gjithë.